



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 509 Akti

Nr. 316 Vendimi
Tiranë, më 17.11.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja	Kryesuese
Suela Zhegu	Relatore
Olsi Komici	Anëtar

asistuar gjatë procesit të vendimarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani të vëzhguesit ndërkombëtarë Tonci Petkovic, në datën 13.11.2020, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Ibrahim Hoxha**, ish gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;

Vendimi nr.78, datë 12.12.2017 i Gjykatës Kushtetuese.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, znj. Suela Zhegu, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe pasi analizoi çështjen në tërësi, bazuar në vlerësimin tërësor të procedurave, sipas pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Ibrahim Hoxha është subjekti i rivlerësimit, për shkak të funksionit të tij, si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe bazuar në të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 84/17, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, dhe në ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, pasi u përzgjodh me shortin e hedhur, më datë 15.6.2020, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit” (në vijim “Komisioni”).
3. Referuar nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin ka filluar menjëherë me caktimin me short të trupit gjykues, me këtë përbërje: komisionere Suela Zhegu me cilësinë e relatores dhe me cilësinë e anëtarit komisionerët: Etleda Çiftja e Alma Faskaj.
4. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI) sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016;
5. Komisioni, me vendimin nr. 61, datë 5.10.2020, për shkak të gjendjes shëndetësore, të komisioneres Alma Faskaj, ka vendosur zëvendësimin e saj, me komisionerin Olsi Komici, i përzgjedhur me short me cilësinë e anëtarit zëvendësues, të këtij trupi gjykues.
6. Trupit gjykues në mbledhjen e të datës 12.10.2020, ka caktuar me mirëkuptim, kryesuesen e trupit gjykues znj. Etleda Çiftja, si dhe u deklarua mospasia e konfliktit të interesit nga ana e secilit prej anëtarëve të këtij trupi.
7. Relatori i çështjes në bazë të neneve 33 dhe 39 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e përpiluara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); dhe Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK).
8. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga ana e subjektit të rivlerësimit janë nisur procedurat e rivlerësimit:
 - a. me plotësimin dhe dërgimin e deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2, të ligjit nr. 84/2016, pranë ILDKPKI-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
 - b. plotësimin dhe dërgimin e deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3, të ligjit nr. 84/2016, pranë DSIK, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
 - c. plotësimin dhe dërgimin e formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.

9. Komisioni, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme, për subjektin e rivlerësimit Ibrahim Hoxha, me shkresën nr. **** datë 24.9.2020 ka kërkuar informacion dhe dokumentacion pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

10. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me shkresën nr. ***, datë 02.10.2020 ka dërguar dokumentacion të plotë, ndër të tjera, dhe kopje të vendimit nr. **, datë 9.5.2017 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD), mbi shkarkimin nga detyra të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Ibrahim Hoxha, për shkak se është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

11. KLD, bazuar në nenin 140, pika 2 të Kushtetutës së Republikës, dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka vlerësuar se vendimi i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda me nr. **, datë 12.4.2017, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda me nr. ***, datë 21.12.2016, i cili e ka konsideruar fajtor dhe dënuar gjyqtarin Ibrahim Hoxha. Ky vendim është i formës së prerë dhe detyrim për tu zbatuar. Vepra penale e korrupsionit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të drejtësisë, për të cilën është dënuar gjyqtari, cilësohet nga Kodi Penal si një krim, të cilit i korrespondojnë dhe masat e dënimit. Këshilli, pasi ka evidentuar se vendimi penal i dënimit ka marrë formë të prerë, ka vendosur të shkarkojë nga detyra gjyqtarin Ibrahim Hoxha, për shkak se është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

12. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 140, pika 2/b, përcakton në mënyrë taksative se gjyqtari shkarkohet nga detyra, ndër të tjera, edhe kur është dënuar me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

13. Gjykates Kushtetuese, me shkresën me nr. ***, datë 6.11.2020, informon se në regjistrin e çështjeve për ankimet në kuadër të Juridiksionit Disiplinor, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, nuk është regjistruar ankim nga z. Ibrahim Hoxha ndaj vendimit nr. **, datë 09.05.2017 të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë,

14. Komisioni me shkresën nr. *** prot., datë 29.10.2020, drejtuar KLGJ-së, si organ kompetent, i ka kërkuar të shprehet në lidhje me statusin e magjistratit për subjektin e rivlerësimit Ibrahim Hoxha.

15. Këshilli i Lartë i Gjyqësor me shkresën nr. **** prot., datë 11.11.2020, është shprehur ndër të tjera se: [...] ndaj gjyqtarit Ibrahim Hoxha është marrë masë disiplinore e shkarkimit nga funksioni, nga organi kompetent sipas ligjit të kohës, ish KLD-së, vendim kundër të cilit, gjyqtari i shkarkuar nuk ka paraqitur ankim brenda afatit të përcaktuar në ligji. Për këtë arsye, Vendimi ***, datë 09.05.2017, i ish KLD-së, konsiderohet se ka marrë formë të prerë, duke pasqyruar dhe efektet juridike përkatëse. Nisur nga kjo, në kushtet kur “shkarkimi nga funksioni për përgjegjësi disiplinore” përbën një nga rastet e mbarimit të statusit të magjistratit, sipas parashikimit të shkronjës “ç” të nenit 64, të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor, konfirmon se z. Ibrahim Hoxha i ka mbaruar statusi i magjistratit.

II. ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

16. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

17. Trupi gjykues konstaton se, z. Ibrahim Hoxha, ka qenë me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke qenë kështu në rrethin e subjekteve të rivlerësimit që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit ex-officio.

18. Në referim të gërmës “ç”, të pikës 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndër të tjera përcaktohet se: “statusi i magjistratit mbaron në rastet kur shkarkohet nga funksioni”.

19. Trupi gjykues, pasi u njoh me vendimin nr. ***, datë 09.05.2017, të KLD-së, për shkarkimin nga detyra e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Ibrahim Hoxha, për shkak të një dënimi penal të formës së prerë si dhe me shkresën me nr. ****, datë 29.9.2020 të Gjykatës së Lartë, ku informohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur ankim ndaj vendimit nr. **, datë 09.05.2017 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit Ibrahim Hoxha është shkarkuar nga detyra e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak se është dënuar me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një krimi. Në këto kushte, subjekti ka humbur statusin e magjistratit.

20. Këshilli i Lartë i Gjyqësor me shkresën nr. **** prot., datë 11.11.2020, është shprehur ndër të tjera se: [...] ndaj gjyqtarit Ibrahim Hoxha është marrë masë disiplinore e shkarkimit nga funksioni, nga organi kompetent sipas ligjit të kohës, ish KLD-së, vendim kundër të cilit, gjyqtari i shkarkuar nuk ka paraqitur ankim brenda afatit të përcaktuar në ligji. Për këtë arsye, Vendimi **, datë 09.05.2017, i ish KLD-së, konsiderohet se ka marrë formë të prerë, duke pasjellë dhe efektet juridike përkatëse. Nisur nga kjo, në kushtet kur “shkarkimi nga funksioni për përgjegjësi disiplinore” përbën një nga rastet e mbarimit të statusit të magjistratit, sipas parashikimit të shkronjës “ç” të nenit 64, të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor, konfirmon se z. Ibrahim Hoxha i ka mbaruar statusi i magjistratit.

21. Trupi gjykues ka arritur në përfundimin se mbarimi i statusin të magjistratit sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen.

22. Nenin 95 i Kodit të Procedurave Administrative, ka parashikuar “Pamundësinë në objekt apo qëllim” ku sipas kësaj dispozite, Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.

23. Në zbatim të kësaj dispozite, për faktin që subjekti i rivlerësimit nuk gëzon statusin e magjistratit, trupi gjykues vlerëson të përfundojë procesin e rivlerësimit kalimtar për z. Ibrahim Hoxha, pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin 4, pika 6, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në pikën 2/b të nenin 140 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në gërmën “ç” të pikës 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenin 95, të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Ibrahim Hoxha, pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti i rivlerësimit ka humbur statusin e magjistratit.
2. Ky vendim u njoftohet: subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 13.11.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda ÇIFTJA
Kryesuese

Olsi KOMICI
Anëtar

Suela ZHEGU
Relatore